



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 25

Prishtinë, më 16.6.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selviqe Halimi, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Donika Kadaj-Bujupi, Nezir Çoçaj dhe Milena Miliçević.

Munguan: Fatmir Limaj, Agim Aliu, Doruntinë Maloku dhe Danush Ademi.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Zahir Çerkini dhe Hamit Mjeku-Praktikantë në Kuvend; Florin Merovci-ZPRK; Alma Tafarshiku-EULEX; Valdet Hajdini-IKD; Jean Claude Schlumberger-OSBE; Fitim Mulolli OSBE; Christofer Tuetsch OSBEE; Luljeta Krasniqi OSBE; Blerta Bejtullahu EUSR/EU Office; Kaltrina Ahmeti GPLS; Labearta Mjeku-Fakulteti Juridik; Shaban Murturi-EUSR/EU Office; Florina B.-EUSR; Fitore Hajdini Berisha-ZPRK; Valmire Hoti-Infodirekt.tv; Drilon Asllani-Radio Dukagjini; Artan Canhasi-KDI; Sylë Ahmeti-Kosova Sot dhe Qëndresë Mustafa-BIRN.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.4.2015,

3. Shqyrtimi i raportit vjetor i punës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për vitin 2014;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;
5. Shqyrtimi i propozimit të Lidhjes së Juristëve të Kosovës për emërimin e anëtarit në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës;
6. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës u miratua me ndryshime: pika e tretë hiqet nga rendi i ditës si pasojë e mospranisë së Kryetares së KQZ-së për raportim. Ajo gjithashtu theksoi se para se të fillojnë me pikat e rregullta të rendit të ditës, i pranishëm është Ambasadori i OSBE-së në Kosovë z. Jean Claude Schlumberger, me të cilin tha ajo, do të zhvillojmë një takim për të diskutuar për punën e Komisionit për Legjislacion dhe mbështetjen që mund t'i ofrohet nga OSBE-ja..

Takimi me Ambasadorin e OSBE-së

Kryetarja theksoi se ndihet e nderuar me praninë e Ambasadorit në Komisionin për Legjislacion. Ajo fillimisht falënderoi atë për përkrahjen që ofron si institucion dhe për gjetjen e kohës për një takim të tillë. Ajo paraqiti një rezymë për punën e Komisionit dhe rolin e tij që e ka në Kuvend, duke përfshirë rolin mbikëqyrës, iniciativat ligjore, ndryshim-plotësimin e ligjeve. Ajo njoftoi edhe me ndryshim-plotësimet e pakos së ligjeve të drejtësisë.

Jean Claude Schlumberger fillimisht falënderoi anëtarët e Komisionit për gatishmërinë e treguar që të mbahet ky takim i përbashkët. Ai theksoi se e pa të arsyeshme që në fillim të kësaj legjislature të takojë komisionet kryesore parlamentare dhe liderët e tyre, me ç'rast është duke ndodhur edhe ky takim. Ai theksoi nevojën për të bashkëpunuar me Komisionin dhe të shkëmbejnë përvojat, në mënyrë që të krijohet lidhje më e ngushtë mes të dy institucioneve, dhe në këtë mënyrë të mbështesim punën e Komisionit. **Schlumberger** foli për aktivitetet që OSBE-ja ka mbështetur dhe do të mbështesë Komisionin, pastaj përshëndeti bashkëpunimin e ngushtë që kanë institucionet në fushën e shqyrtimit legjislativ, duke përmendur këtu ndryshimet që kanë ndodhur në pakon e ligjeve të drejtësisë.

Kur jemi te këto ndryshime, tha ai, vëmendja e OSBE-së ka qenë të krijimi i një sistemi të qëndrueshëm trajnimi për gjyqtarët dhe prokurorët. Gjithashtu, ai theksoi se janë duke punuar me projekte për fuqizimin e sundimit të ligjit në komunat veriore të Kosovës, në mënyrë që ato t'i ndërtojnë institucionet e tyre në përputhje me ligjet e Republikës së Kosovës. **Schlumberger** njoftoi Komisionin për ndihmën që ofron OSBE-ja për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas,

veçanërisht kur bëhet fjalë për përdorimin e gjuhëve në procedurë, ndërsa foli edhe për problemin e mosnjohjes së diplomave për studentët shqiptarë.

Si përfundim ai vlerësoi punën e Komisionit dhe, shprehu gatishmërinë për të vazhduar bashkëpunimin dhe mbështetjen për të.

Selvije Halimi fillimisht falënderoi Ambasadorin për prezencën e tij dhe për përkrahjen që institucioni që e përfaqëson është duke e dhënë për Komisionin për Legjislacion. Ajo theksoi se është mirë për tu thënë se transparenca nuk mungon në këtë Komision, dhe si rezultat i saj shumë aktorë të jashtëm janë përfshirë në procesin e ligjbërës.

Halimi ngriti çështjen e njohjes së diplomave nga ana e dy shteteve, por theksoi se pengesa më të mëdha po bëhen nga ana e shtetit serb, dhe gjendja është më shqetësuese për studentët e Luginës së Preshevës andaj, do të ishte mirë që bashkësia ndërkombëtare të bëjë më shumë në këtë drejtim në mënyrë që të bëhet realizimi i plotë i marrëveshjes.

Donika Kadaj Bujupi pasi falënderoi Ambasadorin për prezencën e tij, ngriti dy çështje që sipas saj duhet të fuqizohen në rregulloren e punës së Kuvendit, e që janë: Grupi i Grave Deputete dhe transparenca dhe llogaridhënia e Qeverisë para Kuvendit. Tek e para ajo theksoi bashkëpunimin e ngushtë dhe përkrahjen që ka pas ky grup nga ana e OSBE-së, ndërsa sa i përket pikës së dytë, ajo theksoi se kemi një mbyllje të qeverisë, dhe një mospërgjigje në pyetjet parlamentare dhe në interpelanca, dhe se kërkon ndihmën e ekspertëve të OSBE-së që kjo çështje të fuqizohet më shumë në rregullore.

Armend Zemaj falënderoi Ambasadorin për prezencën e tij në Komision dhe bashkëpunimin që i ofron punës së Komisionit. Ai theksoi se pret të ndërtojë edhe më tutje një partneritet korrekt me OSBE-në sa i përket bashkëpunimit të mundshëm në fushën ligjbërëse, duke pranuar ekspertë të lëmenjve të caktuara në Komision. Ai, gjithashtu, njoftoi edhe me punën e Nënkomisionit, me anë të së cilit po synohet të bëhet një ligj dhe rregullore sa më e mirë për Kuvendin, me qëllim që të avancohet puna e tij.

Milena Miliqeviq falënderoi ambasadorin, duke shtuar se u përmendën disa fusha që kanë të bëjnë me komunitetet pakicë, në këtë rast për komunitetin serb. E përmenda këtë, shtoi ajo, që mos të them keqpërdorimin e gjuhës zyrtare për arsye se ndodhë shumë herë që rregullat të interpretohen në mënyra të ndryshme nga komuniteti shqiptar apo serb. Ky problem në të ardhmen shumë shpejt do të zgjidhet dhe shpresojmë që në të ardhmen mos të vijmë në situata konfliktuale për këtë.

Kurse, sa i përket çështjes së diplomave, tha se vërtet është një aspekt i rëndësishëm sepse njerëzit janë të kufizuar me rastin e konkurrimit në vende pune kur shpallen konkurset në disa institucione. Ajo ishte e mendimit se duhet të njihen diplomat, ashtu siç kemi vepruar me policinë dhe gjendjen civile të cilëve ju është njohur diploma e kjo duhet të vlejë edhe për jurisprudencën.

Jean Claude Schlumberger, si përfundim ngriti dy çështje: e para kishte të bënte me zbatimin e ligjit që sipas Ambasadorit ka dallim në mes asaj se çka përmbajnë ligjet. Ai theksoi se çdo detj në këtë drejtim është i rëndësishëm, sikurse edhe puna e Komisionit. Andaj, ai theksoi se duhen trajnime sidomos në sistemin gjyqësor në mënyrë që të kemi efikasitet në punë, dhe se OSBE-ja do të ofroj ndihmën e duhur në këtë drejtim. Çështja e dytë të cilën ai e ngriti ishte fuqia e Kuvendit si organ, kështu ai bëri një lidhje në mes asaj çka u prezantua nga ana e anëtarëve të Komisionit në lidhje me mungesën e transaprencës në kuvend nga ana e Qeverisë, me ç'rast theksoi se ajo duhet rritur dhe se institucioni që ai pëfaqëson është i gatshëm në këtë drejtim të ofroj mbështetje. Ai, gjithashtu, diskutoi edhe për Grupin e Grave Deputete, për të cilin theksoi se do të ketë angazhim nga ana e OSBE-së që të fuqizohet.

Kryetarja në fund e njoftoi Ambasadorin edhe për dy çështje tjera, siç janë: procesi i mbikëqyrjes buxhetore nga ana e Komisionit, në të cilin nuk ka pas shumë angazhim për shkak të vëllimit të madh të punës dhe, e dyta në lidhje me draftimin e Rregullores së grupit të Grave Deputete.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 28.4.2015;

Kryetarja konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin nga mbledhja e mbajtura më 28.4.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik;

Kryetarja theksoi se është hera e dytë që projektligji sillet në Kuvend. Në herën e parë, mes dy leximeve MD-ja e ka tërhequr projektligjin, dhe e ka sjellë një version tjetër që ka dallim nga ai i pari dhe se është mjaft teknik. Gjithashtu, MD-ja ka thënë se e ka hartuar këtë projektligj në bashkëpunim me AKK-në, por një gjë të tillë e ka mohuar vet drejtori i AKK-së.

Ajo, kërkoi nga ana e anëtarëve të Komisionit që para se të përkrahet në parim projektligji, të organizojmë një dëgjim publik, të ftojme edhe MD-në, dhe në këtë mënyrë të marrim të gjitha vërejtjet për të bërë një draft sa më të mirë të tij.

Selvije Halimi propozoi që së pari të miratohet në parim projektligji, dhe më pas të organizohen dëgjimet publike, ashtu si ka qenë praktika e mëhershme.

Armend Zemaj theksoi se para se të merret vendim për ndonjë propozim, do të ishte mirë të shikohet se çka përfitojmë nga veprimi i caktuar ngase, nuk do të ishte mirë që ne si Komision ta prolongojmë procedurën, duke organizuar dëgjim publik, sepse në këtë mënyrë ne pa e kaluar në

parim nuk do të mund të ndërhyjmë me amendamente. Andaj, ai theksoi se anëtarët e Komisionit le ta analizojnë mirë këtë çështje, ose në të kundërtën të dërgohet projektligji për lexim të parë.

Nezir Çoçaj tha se e mbështet propozimin e kryetares që të organizohet një dëgjim publik me qëllim që të mos ngutemi me punën që bëjmë dhe, në këtë mënyrë të kuptojmë arsyet e vërteta për tërheqjen e projektligjit nga ana e Ministrisë.

Donika Kadaj-Bujupi theksoi se edhe ajo mbështetë propozimin e kryetares, që së pari të organizohet një dëgjim publik.

Milena Miliqeviq tha se përkthimi nuk është i mirë ku ka raste që nuk kuptoj dispozitat e caktuara si tërësi, duke iu referua nenit 8, 12, 14, 15 e kështu me radhë. Ajo ishte e mendimit se shqyrtimi i mëtejshëm duhet të shtyhet për këto arsye.

Agim Ademaj propozoi që projektligji të procedohet tutje, pra të miratohet në parim, dhe mes dy leximeve të organizohen dëgjimet publike, të punohet në draftim, në mënyrë që të nxjerrim një draft më të mirë.

Kryetarja pas diskutimeve hodhi në votim propozimin që para se të miratohet në parim projektligji, të organizohet një dëgjim publik, dhe konstatoi se me 4 vota për, 2 kundër dhe një abstenim, kalon propozimi.

4. Shqyrtimi i propozimit të Lidhjes së Juristëve të Kosovës për emërimin e anëtarit në Këshillin Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës;

Komisioni, e shqyrtoi propozimin e Shoqatës së Juristëve të Kosovës, për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës dhe vlerësoi se propozimi për emërimin e anëtarit është në përputhje me nenin 3.3 të Ligjit nr. 02/L-25, për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës. Lidhur me këtë Komisioni me 4 vota “për” dhe 3 “abstenime”, vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

Të emërohet anëtar i Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, kandidati:

- I. Elvedin Durguti, anëtar nga Shoqata e Juristëve të Kosovës;
- II. Mandati anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës zgjatë 2 (dy) vjet.

6. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës;

Selvije Halimi, theksoi se në cilësinë e kryesueses së grupit punues për këtë projektligj, kemi pas komentet e Avokatit të Popullit, si dhe kemi realizuar një hulumtim nga Kuvendi, në mënyrë që të kemi më të qartë atë se çka po veprojmë. Ajo theksoi gjithashtu se për bindjen e saj personale nuk duhet hequr në tërësi afati i kufizimit ligjor, por vetëm të shtohet ai, andaj theksoi se ka rezerva për këtë dokument por, në fund i mbetet Komisionit që të vendosë se si do të veprojë.

Kryetarja propozoi që ky projektligj ti procedohet Qeverisë për mendim, në përputhje me Rregulloren e Punës.

Armend Zemaj theksoi se do të ishte mirë që të gjendet një zgjidhje që të ftohen të dy institucionet dhe të japin opinionet e tyre, andaj nuk do e kisha dërguar në Qeveri, por duhet ta analizojmë më shumë këtë Projektligj.

Selvije Halimi propozoi që të mos ngutemi dhe të kërkojmë një takim edhe me dikë nga Gjykata Kushtetuese, në mënyrë që të kemi parasysh opinionet e të dy palëve, me qëllim që mos e dëmtojmë procesin.

Agim Ademaj theksoi se nuk duhet të ngutemi dhe të veprojmë, në mënyrë që mos të zgjidhim probleme por vetëm t'i shtojmë ato, pa pasur një analizë të saktë se si do të duhej të ishte afati ligjor për këtë çështje.

Kryetarja konstatoi se në mungesë të konsensusit, Projektligji nuk do të procedohet për mendim në Qeveri, pasi është e nevojshme të bëhen konsultime shtesë.

7. Të ndryshme.

a. Njoftim me shkresën e deputetes Puhie Demaku

Komisioni, e shqyrtoi kërkesën e deputetes Puhie Demaku, e cila ka kërkuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, gjegjësisht nga drejtori i përgjithshëm z. Albert Prenkaj, që në pajtim me Ligjin për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit dhe Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike, të realizojë takim me të njëjtin, për të marrë përgjigje për çështjet që janë të referuara në shkresën e datës 27.2.2015. Në shkresat e lëndës shihet vetëm një komunikim elektronik, duke ia

pamundësuar deputetes në fjalë të realizojë takimin e kërkuar apo të marrë përgjigje në formë të shkruar për çështjet e ngritura.

Lidhur me këtë Komisioni vendosi që zyrës së Kryeministrit t'ia paraqesë këtë:

P ë r f u n d i m

Njoftohet Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës për moszbatimin e Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit (neni 13) dhe të Ligjit për Qasje në Dokumentet Publike nga zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

b. Qarkore për zbatimin e Ligjit për nr. 03/L-111 për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit

Komisioni për Legjislacion, me qëllim të zbatimit të Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit dhe duke u bazuar në faktin se ekzistojnë raste të moszbatimit të ligjit në fjalë nga disa institucione të vendit, e vlerësoi të nevojshëm që të lëshojë qarkore për zbatimin e Ligjit për nr. 03/L-111 për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit.

Qarkorja do ti adresohet Qeverisë (të gjitha ministrive) dhe komunave të Republikës së Kosovës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:45.
E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Albulena Haxhiu
